

VENDIM
Nr. 28 datë 15.2.2017

**MBI MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË KOMP ENERGJI” SHPK, ME
NUMËR. 248, SERIA PV14K, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE NR.94, DATË 6.10.2014, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC-ET “HURDHAS 1”, “HURDHAS 2” DHE “HURDHAS 3”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, pika 1 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë”; VKM-së nr. 840, datë 11.6.2008 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Vinjoll”; nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 109, datë 29.06.2016, të bordit të ERE; nenit 8, të Kontratës Koncesionare, nr. 2807 Rep, dhe nr. 371 Kol, datë 1.9.2009; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.2.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut në lidhje me modifikimin e licencës së aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë Komp Energji sh.p.k.,

Konstatoi se:

- Shoqëria Komp Energji sh.p.k ka kryer pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit siç përcaktohet në aneksin “A” të kësaj rregulloreje, si dhe pagesën e rregullimit për vitin 2015 dhe rezultoni i çliruar nga çdo lloj detyrimi financiar ndaj ERE.

- Shoqëria “Hidropowerplant Construction sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar sipas nenit 9 (Formati dhe dokumentacioni për aplikim) të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec-et “Hurdhas 1, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3 me numër 248, seria PV14K, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr.94, datë 06.10.2014, duke e zëvendësuar emrin e shoqërisë së licencuar “Komp Energji” sh.p.k, me shoqërinë Hidropowerplant Construction sh.p.k.

2. Të njoftohet shoqëria “Komp Energji” sh.p.k., që të depozitojë në ERE, Brenda 10 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, licencën e prodhimit numër 248, seria PV14K, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 94, datë 6.10.2014.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet Ankim në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti